

**MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË OPERATORIN E SISTEMIT TE
TRANSMETIMIT SHA PËR PROJEKTIN “NDËRTIMI I QENDRËS SË RE
DISPEÇER DHE SISTEMI SCADA EMS”**

Raporti përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Ministrinë e Shëndetësisë për Projektin “Rehabilitimi dhe pajisja e pesë poliklinikave” me objekt “Mbi zbatimin e ligjshmërisë, rregullshmërisë së veprimtarisë ekonomiko-financiare” për periudhën e veprimtarisë nga fillimi i projektit deri me datë 30.04.2015 dhe masat për përmirësimin e gjendjes janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr.120, datë 18.09.2015.

Bazuar në nenet 15 dhe 16 të ligjit nr.154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, me shkresën nr. 516/12, datë 18.09.2015, dërguar z. Engjëll Zeqo, Administrator, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. -Projekti “Ndërtimi i qendrës së re dispeçer dhe sistemi SCADA EMS” për programin “Ristrukturimi dhe fuqizimi i sistemit elektrik shqiptar për integrimin në sistemin e Ballkanit: Fuqizimi i aftësive të transmetimit dhe përmirësimi i kontrollit”, është në proces zbatimi dhe ende nuk ka përfunduar, ndonëse është me më shumë se 6 vjet me vonesë.

-Punimet po vazhdojnë për ndërtesën e re të OST dhe qendrën e dispeçerisë, ndonëse kjo godinë duhet të kishte përfunduar. Për arsye të problemeve të ndërthurjes së punimeve me instalimin e pajisjeve, vjen edhe mos instalimi i këtyre të fundit.

-Për kontratën e ndërtimit të qendrës së re dispeçer, kontraktori, është paguar rreth 70% të punës dhe puna e kryer deri në date 24.07.2012, është vetëm 40%, por më datë 05.02.2014, ky kontraktor ka shpall falimentin.

-Nga auditimi në vend i disa nënstacioneve, u konstatua se nuk shkëmbehet informacioni teknik nga nënstacionet: Selitë, Selenicë, Laçi 1, Laçi 2, Traktora, Marinëz dhe ka mbetur pa u lidhur Vlora TPP. (Trajtuar më hollësisht në faqet 29-33 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

Për sa më sipër rekomandojmë:

-Njësia e Zbatimit të Projektit/OST dhe OST SHA, të marrin masa për përfundimin e punimeve për Qendrën e re Dispeçer me qëllim lidhjen dhe shkëmbimin e informacionit teknik në nënstacionet Selitë, Selenicë, Laçi 1, Laçi 2, Traktora, Marinëz, Vlora TPP.

- Njësia e Zbatimit të Projektit /OST dhe OST SHA, të marrin masa për përfundimin e punimeve për Qendrën e re Dispeçer dhe vënien në punë të sistemit SCADA brenda afatit të përcaktuar 31.12.2015, me qëllim arritjen e objektivit kryesor të projektit.

Deri më 31.12.2015

2. -Nga auditimi rezulton se afati i disbursimit jo vetëm që nuk është përmbushur, por ka pasur disa shtyrje për përmbushjen e këtij afati, ku gjithsej afati i disbursimeve është shtyrë me 54 muaj ose më shumë se 4 vite nga afati prej 36 muaj i përcaktuar në marrëveshjen e kredisë.

-Gjithashtu, nga auditimi rezulton se edhe afati disbursimeve deri në fund të muajit gusht 2015, nuk do të mund të përmbushet për arsye se kontrata e lidhur për ndërtimin e Qendrës së re Dispeçer është parashikuar të përfundojë dhe është shtyrë afati i realizimit deri në fund të vitit 2015. (Trajtuar më hollësisht në faqet 34-36 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

Për sa më sipër rekomandojmë:

- Njësia e Zbatimit të Projektit /OST dhe OST SHA të marrin masa që të ardhmen të bëjnë të mundur shtyrjen e afatit të disbursimit, të kërkojnë dhe argumentojnë shtyrjen e afatit

të realizimit të disbursimeve, duke pas parasysh dhe afatin e përfundimit të punimeve për qendrën e re dispeçer.

Deri më 31.12.2015

3. - Njësia e Zbatimit të Projektit Njësia e Zbatimit të Projektit/OST SHA, ndonëse është e detyruar që ta kërkojë shtyrjen e afatit të disbursimeve për më shumë se 1 vit, nuk ka mundur të realizojë në afat përfundimin e kontratave të lidhura për realizimin e komponentëve (aktiviteteve) të projektit. Tejzgjatja e kontratave të punimeve ka sjellë paralelisht edhe shtyrjen e afatit të disbursimeve.

-Nga fondet e akorduara për projektin, fondet për administrim të projektit dhe ndihmë për PIU/OST, të cilat në marrëveshje janë përcaktuar se janë fonde falas për furnizime, blerje dhe shërbime të vogla, në shumën 145,000 euro, nuk i janë dhënë asnjëherë OST SHA/PIU. Për këtë mos zbatim të kushteve të marrëveshjes financiare, pala italiane nuk ka dhënë shpjegime.

-Për kredinë e dhënë nga M.C.Centrale, janë disbursuar gjithsej 13,025,181 euro ose 110 % e fondeve të kredisë të akorduara për projektin “Ristrukturimi dhe fuqizimi i sistemit elektrik Shqiptar për integrimin në sistemin e Ballkanit”. Tejkalmi i fondeve të akorduara për kredinë e MC Centrale, ka ardhur si pasojë e shtesës së miratuar për kontratën “Ndërtimi i nën-stacionit të ri 400/220 kv Tirana 2 dhe zgjerimi i nën-stacionit ekzistues Elbasan 2”.

-Për periudhën nga fillimi i auditimit deri në vitin 2002, nga PIU/OST SHA nuk është bërë raportimi mbi ecurinë e projektit në Ministrinë e Financave në përputhje me VKM nr. 116, datë 24.02.1997.

-Vlera e kontratës me objekt “Realizimi i qendrës së re të dispeçerisë dhe telekontrollit dhe ndërtimi i selisë së re të OST” është në shumën 21,899,436 euro. Për këtë kontratë ka edhe një amendament më datë 23.12.2010, për shtyrje të afatit të përfundimit dhe shtesë të vlerës së kontratës në shumën 1,100,106 euro, por nuk është marrë miratim nga donatori Artigiancassa, veprim në kundërshtim me marrëveshjen e realizimit të projektit, të miratuar me VKM nr. 202, datë 5.04.2006, nenin 14 “Ndryshimet”, ku përcaktohet se çdo ndryshim i marrëveshjes duhet të bëhet nëpërmjet shkëmbimit të notave, nëpërmjet kanaleve diplomatike.

-Për komponentin “Ndërtimi i selisë së re të QDT dhe OST, furnizimi dhe instalimi në selinë re dhe në nënstationin ekzistues të aparaturave në përbërje të qendrës së re Dispeçer dhe Kontrollit të Operatorit të Sistemit të Transmetimit”, pas negociatave të shumta të dy palëve, është rënë dakord që kontratën ta realizojë kontraktori, me afat përfundimi deri më datë 31.12. 2015.

-Për vonesat në realizimin e kontratës “Ndërtimi i selisë së re të QDT dhe OST, furnizimi dhe instalimi në selinë re dhe në nënstationin ekzistues të aparaturave në përbërje të qendrës së re të Dispeçer dhe Kontrollit të Operatorit të Sistemit të Transmetimit”, PIU/OST SHA duhet të marrë masa për mbajtjen e penaliteteve për vonesën, në zbatim të kontratës së datës 20.06.2008. (*Trajtuar më hollësisht në faqet 37-40 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

Për sa më sipër rekomandojmë:

Njësia e Zbatimit të Projektit /OST dhe OST SHA të marrin masa, që me përfundimin e punimeve për Qendrën e re Dispeçer, për vonesat në realizimin e punimeve të llogarisë dhe të mbajë penaltetet për vonesat, në zbatim të kushteve të kontratës datë 20.06.2008.

Menjëherë

4. - Duke analizuar të dhënat e disbursimeve dhe raportet e diferencat që dalin nga shumatat e planifikuara dhe të realizuara të disbursimeve, rezulton se planifikimi nuk është i saktë dhe i studiuar mirë. Planifikimi është hartuar me rezerva dhe është fiktiv.

-Për periudhën nga viti 2008 deri në vitin 2011, nga KESH SHA, nuk është sjellë asnjë informacion dhe kopje të kërkesave për disbursim, për kredinë e M.C. Centrale.

-Sipas marrëveshjeve të kredive, detyrimet për TVSH, taksë doganore dhe kosto të tjera lokale, duhet të sigurohen dhe financohen nga pala shqiptare. Përveç TVSH, për importet dhe punimet civile, për projektin për periudhën objekt kontrolli nga OST SH.A., ka përballuar dhe shpenzimet për kosto lokale (taksë doganore, leje ndërtimi etj), në shumën gjithsej 60,324,676 lekë.

-Në marrëveshjen financiare të projektit “Ndërtimi i qendrës së re dispeçer dhe sistemi SCADA EMS”, për programin “Ristrukturimi dhe fuqizimi i sistemit elektrik shqiptar për integrimin në sistemin e Ballkanit”, shuma e kontributit të palës shqiptare është përcaktuar të jetë 6 milion euro, në fakt shuma e kontributit të përballuar për periudhën objekt auditimi është 10.6 milion euro ose 4.6 milion euro më shumë ose realizuar në masën 178%. Tejkalmi i shumës së kontributit të palës shqiptare ka ardhur për arsye se shuma 6 milion euro është parashikuar vetëm për kredinë e Artigiancassa.

-Në total kosto e projektit nga nisja e tij deri më datë 30.04.2015 duke përfshirë të gjitha burimet e financimit është 71,687,569 euro.

-Për periudhën objekt auditimi shuma e interesave të llogaritur për kredinë e MC Centrale është në shumën 69,126 euro, nga të cilat janë paguar nga OST detyrimet e interesit në shumën 47,280 euro dhe shuma **21,846 euro**, janë detyrime të papaguara dhe i përkasin periudhës 2012-2014. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 40-41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

Për sa më sipër rekomandojmë:

*Njësia e Zbatimit të Projektit/OST dhe OST SHA të marrë masat në mënyrë që të bëjë të mundur pagesat e prapambetura të interesit të papaguar për kredinë e dhënë nga MC Centrale, pasi detyrimet e papaguara për këtë kredi, janë në shumën **21,846 euro**.*

Menjëherë

5. -Detyrimi për pagesat e interesit për kredinë e Artigiancassa është në shumën gjithsej 3,185, 762 euro, nga të cilat 1,601,706 euro janë paguar dhe shuma **1,584,056 euro**, është detyrim i papaguar interesi, që i përkasin periudhës nga viti 2013 deri në 4-mujorin e parë 2015. *(Trajtuar më hollësisht në faqen 41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

Për sa më sipër rekomandojmë:

*Njësia e Zbatimit të Projektit/ OST dhe OST SHA të marrë masat në mënyrë që të bëjë të mundur pagesat e prapambetura të interesit të papaguar për kredinë e dhënë nga Artigiancassa, për arsye se detyrimet e papaguara për këtë kredi janë në shumën **1,584,056 euro**.*

Menjëherë

6. -Për periudhën objekt auditimi për vonesat në pagesat e interesit, për kredinë e Artigiancassa, kamatëvonesat për interesin e papaguar në kohë, të llogaritura nga MF, vetëm për 6-mujorin e parë të vitit 2015 janë në shumën **9,903 euro**, shumë e cila kur të paguhet do të sjellë rritje të kostos së projektit duke shkaktuar dëm ekonomik për të ardhurat e OST SHA, veprim në kundërshtim me nenin 7, seksioni 7.3 të marrëveshjes së nën-huasë. *(Trajtuar më hollësisht në faqen 41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

Për sa më sipër rekomandojmë:

*Njësia e Zbatimit të Projektit/OST dhe OST SHA të marrë masa që në vazhdimësi të kryejë pagesat për interesin e dy kredive brenda afateve të përcaktuara nga Ministria e Financave, për arsye se, si rrjedhojë e mos pagesës në kohë të detyrimeve të kredisë së akorduar nga Artigiancassa, janë llogaritur penalitete, ku vetëm për 6-mujorin e parë të vitit 2015, penalteti është në shumën **9,903 euro**.*

Menjëherë

7. - Për kontratën me objekt “Ndërtimi i n/stacionit të ri 400/220 kv Tirana 2 dhe zgjerimi i n/stacionit ekzistues Elbasan 2”, shtesa e kontratës ka tejkualuar fondet e akorduara nga kredia e MC Centrale për projektin “Ristrukturimi dhe fuqizimi i sistemit elektrik Shqiptar për integrimin në sistemin e Ballkanit”, si dhe vlerën e fondit limit të përcaktuar në planin e kombinuar të prokurimit në shumën 1,086,666 euro (24,740,000 euro vlera e planit të prokuruar - 25,826,666 euro vlera e kontraktuar me gjithë shtesën).

-Për ndryshimin e Planit të Prokurimit, nuk është marrë miratim nga donatori, mungon shkresa për miratim të këtij plani, veprim i cili është në kundërshtim me nenin nr. 5 të Marrëveshjes Financiare, shtojcat nr. 2 dhe nr. 3 të saj, si dhe në kundërshtim me Marrëveshjen “Për realizimin e “Programit për ristrukturimin dhe fuqizimin e sistemit elektrik shqiptar për integrimin në sistemin e Ballkanit: Fuqizimi i aftësive të transmetimit dhe përmirësimi i kontrollit”, miratuar me VKM nr. 220, datë 05.04.2006 e marrëveshjen financiare ratifikuar me ligjin nr. 9657, datë 11.12.2006. Për sa më lart rezulton se shuma **1,086,666 euro ka rënduar koston e projektit objekt auditimi.** (Trajtuar më hollësisht në faqen 42 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

Për sa më sipër rekomandojmë:

*Njësia e Zbatimit të Projektit/OST dhe OST SHA, të marrin masa që në të ardhmen për projektet me financime të huaja, në të gjitha rastet e ndryshimeve për Planet e Prokurimeve, të merret miratimi i donatorëve, si dhe të mos ketë tejkualim të fondit limit, për arsye se për projektin “Ndërtimi i ri i qendrës dispeçer”, rezulton se është tejkualuar fondi limit në shumën **1,086,666 euro**, duke rënduar koston e projektit.*

Menjëherë

8. -Njësia e Menaxhimit të Projektit (PMU) pranë Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, deri në vitin 2012 në strukturën e saj ka pasur personel prej 3 punonjësish, 1 drejtor dhe 2 specialist. Në vitin 2013, PMU është bërë pjesë integrale e Drejtorisë së Integritetit dhe Projekteve të Ministrisë, dhe në përbërje të saj ka vetëm një specialist. Ky ndryshim i konfigurimit të PMU-së, është veprim në kundërshtim me Marrëveshjen Financiare si edhe me Marrëveshjen e zbatimit të projektit.

- Njësia e Menaxhimit të Projektit dhe MEI nuk ka hartuar dhe nuk ka kryer mision monitorimi mbi ecurinë e projektit, si dhe nuk është bërë monitorim i përbashkët midis MEI dhe Artigiancassa, veprim në kundërshtim me marrëveshjen e zbatimit të projektit.

-Në zbatimin e punimeve civile të tenderit me objekt “Ndërtimi i Qendrës së re Dispeçer dhe të Telekontrollit”, nga mbikëqyrësit e punimeve nuk është mbajtur dokumentacioni teknik si, situacione, ditarë punimesh, librezë e masave, etj. (Trajtuar më hollësisht në faqen 47 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

Për sa më sipër rekomandojmë:

Njësia e Zbatimit të Projektit/OST dhe OST SHA të marrë masa, që ti kërkojë mbikëqyrësve të punimeve, ndjekjen e punimeve sipas projekt zbatimit të ndryshuar dhe plotësimin me dokumentacionin teknik, si ditarë punimesh, librezën e masave, situacione, etj.

Vazhdimisht

9. -Në zbatimin e punimeve civile të ndërtesës, janë bërë disbursime me tepër me vlerë 146,358.82 euro, ndërkohë që disbursimi për realizimin e zërave të punimeve deri në përfundim të kontratës ka vlerë më të madhe se vlera e pa disbursuar. (Trajtuar më hollësisht në faqet 49-57 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

Për sa më sipër rekomandojmë:

Administratori dhe Këshilli Teknik i OST, të analizojnë dhe të marrin masa për kryerjen e disbursimeve të mbetura mbi likuidimin e punimeve civile për punimet e ndërtesës dhe të infrastrukturës duke bërë azhurnimin në vazhdimësi duke ruajtur vlerën e kontraktuar të objektit sipas kontratës së lidhur.

Menjëherë

10. -Nga auditimi i punimeve në terren, zëri “Punime sanitare”, në sasinë 11 njësi, rezulton se është realizuar pjesërisht për 5 njësi me vlerë 21,770.33 euro, për arsye të ndryshimit të projektit të zbatimit, projekt i cili është miratuar nga Këshilli Teknik i OST SHA. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 49-57 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

Për sa më sipër rekomandojmë:

Administratori dhe Këshilli Teknik i OST, të analizojnë dhe të marrin masa që Sektori i Financës dhe Njësia e Menaxhimit të Projektit, në disbursimin përfundimtar të Kontraktorit, të certifikojë punimet sanitare, aktualisht të përfunduara, si dhe të zbresë vlerën prej 21,770.33 euro për punimet sanitare, të cilat nuk do të realizohen për efekt të ndryshimit të projektit të zbatimit.

Menjëherë

11. -Për ndërtimin e qendrës së re dispeçer, më datë 23.12.2010 është lidhur shtesë kontrate ndërmjet OST dhe shoqërisë së përkohshme të ndërmarrjeve me vlerë 1,100,106 euro. Shtesa e kontratës i referohet disa ndryshimeve në zërat e preventivit dhe konkretisht ka ndryshim zërash për sa i përket telekomunikacionit dhe rrjetit të fibrës optike, impianteve të RTU dhe modifikimeve të pjesës civile të godinës së re, por në këtë shtesë kontrate nuk duhet të ishin përfshirë edhe pjesët rezervë të cilat janë parashikuara në preventivin fillestar dhe atë final. Pra, pjesët rezervë nuk janë zëra të rinj për projektin, por kanë qenë të parashikuara. Këto zëra duke u llogaritur brenda vlerës së shtesës së kontratës, rrisin fiktivisht vlerën e saj, për arsye se janë preventivuar dy herë. Vlera e pjesëve rezervë prej 435,098 euro ka qenë pjesë integrale e kontratës fillestare. *(Trajtuar më hollësisht në faqen 58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

Për sa më sipër rekomandojmë:

Njësia e Zbatimit të Projektit/OST dhe OST SHA, të marrë masat për të mos likuiduar 2 herë vlerën prej 435,098 euro, për pjesët rezervë që janë të përfshira në shtesën e kontratës datë 23.12.2010, për arsye se këto pjesë janë të parashikuara në preventivin e kontratës datë 20.06.2008 dhe likuidimi i tyre te shtesa e kontratës paraqet risk, për arsye se do të sillte rritje fiktive të kostos së projektit.

Në Vazhdimësi

12. -Mungon dokumentacioni i cili vërteton kryerjen e punëve ose të shërbimeve, aktet e marrjes në dorëzim të pajisjeve të furnizuara e komisionuara sipas kontratës dhe anekseve të saj ku përcaktohet se, pagesat do të kryhen pas aprovimit të autoritetit kontraktor.

-Nuk ka dokument zyrtar që të vërtetojë se mallrat e prokuruar janë montuar dhe lënë në dispozicion të njësive operative të OST, si mallra në ngarkim të këtyre njësive, duke e bërë të pa mundur marrjen e masave dhe ndarjen e përgjegjësive në rast dëmtimi ose keq përdorimi.

-Nuk ka situacion për punimet e kryera, ku të pasqyrohet montimi i pajisjeve ose instalimi i programeve kompjuterike të sistemit SCADA.

-Referuar MLS-2, MLS-3 dhe MLS-4, mbi testimet e kryera në fabrikë, rezulton të jenë kryer fiktivisht, pasi mungon dokumentacioni justifikues i cili vërteton kryerjen e testeve në fabrikë.

-Mungojnë dokumentet justifikuese që vërtetojnë se përfaqësuesit e OST kanë marrë pjesë në testimet e kryera jashtë shtetit pranë fabrikës së

-Salla e dispeçerisë nuk është implementuar tek godina e re sipas projektit por tek Tirana-2. OST, nuk disponon asnjë dokument tek i cili të argumentohet se përse duhej implementuar më parë tek Tirana-2.

-OST, nuk disponon asnjë dokument zyrtar, kontratë ose akt-marrëveshje me, ku të specifikohet se salla e dispeçerisë do të transferohet tek godina e re pa krijuar probleme në funksionimin e sistemit. Aktualisht, ambienti ku ndodhet salla e dispeçerisë,

nuk është i përshtatshëm për postet e punës sipas projektit dhe VDU-të, si dhe njësitë kompjuterike janë të shpërndara nëpër dhoma ashtu edhe printerët të cilët sipas projektit duhet të jenë në një ambient të përbashkët dhe të menaxhueshëm nga të gjithë operatorët, sipas skemës së funksionimit. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 50-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

Për sa më sipër rekomandojmë:

Njësia e Zbatimit të Projektit PIU/OST, të marrë masa për lidhjen e një marrëveshjeje ose të një kontrate shtesë pa kosto ku të specifikohen qartazi kushtet teknike të transferimit të sallës së dispeçerisë nga Tirana 2, tek godina e re pasi ajo të përfundojë. Të marrë masa për krijimin e kushteve të punës së operatorëve sipas standardeve teknike dhe parametrave të projektit edhe pse aktualisht operohet tek Tirana 2.

Menjëherë

13. -Pajisjet FOX, “Parts of telecommunication equipment” në shumën 650,000 euro, janë bërë upgrade në të njëjtën kohë që janë paguar si të reja.

- në shumën 19,500 euro, është i dëmtuar dhe jashtë funksionit.

-Janë kryer pagesat dhe zhdoganimet për pajisjet “TVC 1-p”, “TVC 3-p”, “Izolatorë qelqi”, “Armadio FOX” tek Tirana Center Substation, “Projektorë me aksesoret e montimit” dhe “Ekran projektimi i video projektorit” në shumën 140,795.21 euro. Për këto vlera, nuk ka asnjë dokument zyrtar që të vërtetohet se këto pajisje janë në magazinat e OST ose të kolauduara, testuara dhe montuara në nënstacionet përkatëse. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 58-60 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

Për sa më sipër rekomandojmë:

Njësia e Zbatimit të Projektit/OST dhe OST SHA, të marrin masa për mirë menaxhimin e aktiveve, për marrjen në dorëzim të pajisjeve dhe materialeve sipas urdhrave të administratorit të shoqërisë, ku të përcaktohen personat përgjegjës për marrjen në dorëzim dhe mirëmbajtjen e pajisjeve pasi të jenë kryer kolaudimet e tyre.

Menjëherë

14. -Në disa nënstacione, monitorimi dhe kontrolli lokal është jashtë pune dhe operatorët e këtyre nënstacioneve nuk mund të monitorojnë asgjë nga parametrat e kërkuar për monitorim nga sistemi SCADA si, ngarkesa, temperatura, energjia aktive dhe reaktive, takimi dhe stakimi i bllok-kontakteve, etj. Gjendja e N/Stacioneve Traktori dhe Marinzë, është jashtë kushteve teknike për funksionim normal të sistemit. Ky fakt vërteton se për investimet në nënstacione të tilla të cilat janë të vjetra nuk janë analizuar më parë kriteret tekniko-ekonomike.

-Nuk monitorohen nënstacionet 110kv , si nënstacioni i Fierit nga i cili pas komunikimit me dispeçerinë qendrore në Tirana-2, monitorimi dhe komandimi i nënstacionit nga kjo dispeçeri kryhet vetëm për linjat 220kv dhe vetëm nëse lokalisht i delegohet e drejta dispeçerisë qendrore. Për linjat 110kv, qendra dispeçer, nuk kryhen dot asnjë ekzekutim të komandave dhe as monitoron temperaturat e auto-transformatorëve. Investimi në këto nënstacione, është i destinuar të amortizohet shumë shpejt, sidomos tek N/St, ku paisjet janë të montuara jashtë kushteve dhe parametrave teknik. Vlera totale në masën **364,300 euro, përbën investim me efekt negativ** duke sjellë rritje fiktive për koston e projektit. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 61-62 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

Për sa më sipër rekomandojmë:

Njësia e Zbatimit të Projektit/OST dhe OST SHA, të marrë masa për mirë menaxhimin e fazës së zbatimit të projektit duke ndjekur politika menaxhimi afatgjata me qëllim shmangien e investimeve të panevojshme dhe të analizojnë më parë kriteret tekniko-ekonomike ose të kërkojnë mbledhjen e këshillit teknik për miratimin e ndryshimeve sipas interesave financiare dhe menaxheriale në favor të OST SHA, për arsye se në disa

nënstacione investimi në vlerën 364,300 euro, ka sjell efekt negativ dhe rritje fiktive të kostos të projektit .

Menjëherë

15. -Disa telefona VOIP, të instaluar nëpër sheltera janë jashtë pune madje të pa kolauduar sepse ambalazhi i tyre nuk është hapur. (Trajtuar më hollësisht në faqet 58-59 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

Për sa më sipër rekomandojmë:

Njësia e Zbatimit të Projektit/OST dhe OST SHA, të marrë masa që personat përgjegjës për mirëmbajtjen e rrjetit të telekomunikacionit të garantojnë mbarëvajtjen e punës dhe lënien në funksion të pajisjeve të telekomunikacionit.

Menjëherë

16. -Në nënstationin Elbasani-2, tek pajisjet RTU, mungojnë disa karta sepse janë dëmtuar. Gjithashtu, u konstatua se edhe shelteri në nënstationin Kajan, është i dëmtuar dhe jashtë funksionit. Për pajisjet e dëmtuara, nuk është kryer asnjë procedurë, për riparimin e tyre.

Mos ekzistenca e pjesëve rezervë, të cilat duhet të ishin siguruar në përputhje me kontratën, ka sjell mangësi në funksionimin e sistemit.

Një fakt tjetër për nevojën e blerjes së pjesëve rezervë, është (Trajtuar më hollësisht në faqet 58-59 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

Për sa më sipër rekomandojmë:

-Njësia e Zbatimit të Projektit/OST dhe OST SHA, të marrin masa për riparimin dhe vënien në funksion të pajisjeve; RTU (N/Stacioni Elbasan-2) dhe shelterin (N/stacionin Kajan), si dhe të përcaktojnë përgjegjësitë për këto pajisje të dëmtuara. Gjithashtu, të merren masa për furnizimin me pjesë rezervë, sepse defektet e mundshme do të ndikonin në funksionimin e sistemit SCADA.

-NJZP/OST dhe OST SHA, të marrin masa që të ardhmen, për marrjen në dorëzim të pajisjeve të montuara nga personat përgjegjës, me qëllim mirëmbajtjen dhe evidentimin e përgjegjësive në rast dëmtimi.

Menjëherë

17. -Nga auditimi u konstatua se akt komisionimet (kolaudimi) e pajisjeve, për bateritë e vendosura nëpër kabinat e ups-ve ose dhe jashtë tyre në N/stacionin e Elb-2, specifikimet teknike janë të njëjta me atë të përcaktuara në kontratë, ndonëse në fakt pajisjet e furnizuara nuk janë në përputhje me specifikimet teknike të miratuara. (Trajtuar më hollësisht në faqet 62-63 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

Për sa më sipër rekomandojmë:

Njësia e Zbatimit të Projektit/OST dhe OST SHA, të marrin masa që për këto pajisje të kryhet zëvendësimi i menjëhershëm me pajisje në përputhje me specifikimet teknike të miratuara sipas kontratës, për arsye kontrata me objekt "Ndërtimi qendrës së re dispeçer dhe i sistemit SCADA-EMS", është ende në proces dhe punimet e ndërtimit, furnizimit dhe vendosjen dhe kolaudimi, përfundojnë më datë 31.12.2015

Menjëherë

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1. -Për ndërtimin e linjës 400 kv Tirana 2, është lidhur kontrata, nr. PRSEAISB/OST/PIU/CLA/02/08, datë 21.02.2008, ndërmjet OST SHA dhe kompanisë me vlerë 12,991,520,64 euro, me afat për përfundimin e punimeve 540 ditë nga data e hyrjes në fuqi të kontratës. Punimet kanë përfunduar në dhjetor të vitit 2011 dhe penaliteti që aplikohet për çdo javë vonesë është 0.5% të vlerës përfundimtare të kontratës. Shuma e llogaritur e penalitetit për vonesën në realizimin e kësaj kontrate është 1,299,152 euro. Kontrata ka përfunduar në datë 23.03.2010. Nga PIU/OST SHA, nuk

është bërë mbajtja e penalitetit për vonesën në realizimin e punimeve, veprim në kundërshtim me kontratën e lidhur më datë 21.02.2008, Kushtet e Veçanta të Kontratës, volumi 2, seksioni 3, pika CS-34, **i cili ka shkaktuar një dëm ekonomik në shumën 1,299,152 euro, detyrim dy që duhet të paguhet nga kontraktori** veprim ky në kundërshtim me kushtet e kontratës datë 21.02.2008. (Trajtuar më hollësisht në faqet 42-43 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

Për sa më sipër rekomandojmë:

Njësia e Zbatimit të Projektit (PIU) dhe OST SHA të marrin masa për arkëtimin e vlerës 1,299,152 euro, nga subjekti, si dëm ekonomik i ardhur nga mos llogaritja e penaliteteve për vonesat e shkaktuara në përfundimin e kontratës për ndërtimin e linjës 400 kv Tirana 2, veprim në kundërshtim me kushtet e kontratës datë 21.02.2008 .

Menjëherë

2. - Më datë 18.06.2004, midis PMU/METE (sot MEI) dhe është lidhur kontrata me objekt “Shërbime inxhinierike për “Programin e ristrukturimit teknik dhe fuqizimin e sistemit elektrik Shqiptar”. Objekt i kësaj kontrate është, i ndarë në katër aktivitete.

Për pagesat e konsulentit PMU/MEI, nuk ka bërë ndalesën e tatimit të të ardhurave në masë 10%. Kompania, nuk rezulton se është subjekt rezident në vendin tonë dhe nuk është regjistruar në QKR. Nga PMU/MEI nuk është kërkuar dhe nuk është bërë ndalesa në masën 10% e tatimit në burim për të ardhurat e përfituara nga kompania dhe të gjeneruara në territorin e RSH, veprim ky në kundërshtim me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, ku në nenin 5 përcaktohet se “Tatim” është pagesa e detyrueshme dhe e pakthyeshme në Buxhetin e Shtetit, apo në buxhetin e organeve të qeverisjes vendore. Për kontratën e lidhur për shërbime inxhinierike nuk është mbajtur për çdo pagesë në masën 10%, veprim ky në kundërshtim me kuadrin ligjor në fuqi.

- Kompania, nuk figuron e regjistruar në regjistrin Tregtar Shqiptar dhe në Degën e Tatimeve, pra është subjekt jo rezident në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe bazuar në legjislacionin tatimor në fuqi, çdo subjekt qoftë ky dhe jo rezident, që kryen aktivitete ekonomike në vendin tonë, duhet të paguajë tatim në burim për të ardhurat e përfituara nga zhvillimi i aktivitetit të tij ekonomik, pasi në nenin 9 të ligjit nr. 9920, datë 10.05.2008 është përcaktuar se të gjitha të ardhurat, me burim në Shqipëri, janë objekt i tatimit përfundimtar, të mbajtur në burim. Agjencia e Zbatimit të Projektit, duhet të kishte kërkuar zbritjen e vlerës së tatimit mbi të ardhurat e përfituara nga kompania konsulente, në masën 10% për çdo pagesë të kryer dhe shuma përkatëse duhej mbajtur dhe derdhur në Degën e Tatimeve Tiranë. Nga sa më sipër rezultoi se, për Buxhetin e Shtetit është shkaktuar **një dëm ekonomik në shumën 222,654 euro**. (Trajtuar më hollësisht në faqen 45 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

Për sa më sipër rekomandojmë:

Njësia e Menaxhimit të Projektit, PMU/MEI, të marrë masa për arkëtimin e vlerës 222,654 euro, dëm ekonomik nga subjekti, i shkaktuar nga mos llogaritja dhe mbajtja e tatimit në burim në masën 10%, veprim ky në kundërshtim me nenet 4, germa “c”, 7 si dhe nenin 33, germa “d” e pika 2, të ligjin nr. 8438, date 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” me ndryshimet përkatëse, të Udhëzimeve të Ministrisë së Financave të nxjerra në zbatim të tij, me nenet 6 pika 1, 8 pika 2 dhe 9 të ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, si dhe me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 6, datë 10.02.2004 “Për marrëveshjet bilaterale për shmangen e taksimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal”.

Menjëherë

3. -Për komponentin “Ndërtimi i nënstacionit 400/220 kv Tirana 2 dhe zgjerimi i nënstacionit ekzistues Elbasani 2”, punimet për nënstacionin kanë përfunduar më datë 11.11.2011, pra jo brenda afatit të përcaktuar. Për këtë vonesë edhe nga auditimi i mëparshëm është lënë rekomandim që të llogariteshin penalitetet, i cili aplikohet për çdo javë vonesë në masën 0.5% të vlerës përfundimtare të kontratës. OST Sha ka bërë vetëm llogaritjen e penalitetit në shumën 2,582,666 Euro, dhe me shkresën nr. 1149, datë 07.03.2012, i ka përcjellë METE (sot MEI), kërkesën për marrjen e masave për mbajtjen e penaliteteve, për arsye se sipas Marrëveshjes së zbatimit të projektit, Ministria bën ndjekjen e pagesave për këtë kontratë.

-Kontraktorit, jo vetëm që nuk i është bërë me dije shuma e penalitetit, por me shkresën nr. 2292/1, datë 12.04.2012, METE (sot) MEI është dhënë sqarimi se nuk ka vend për mbajtje penaliteti.

Për sa më lart, mos mbajtja e shumës së penalitetit, është veprim në kundërshtim me kontratën datë 21.02.2008, Kushtet e Veçanta të Kontratës, volumni 2, seksioni 3, pika CS-34, **duke sjellë një dëm ekonomik në shumën 2,582,666 euro, detyrim ky që duhet të paguhet nga kontraktori** (Trajtuar më hollësisht në faqen 45 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

Për sa më sipër rekomandojmë:

Njësia e Menaxhimit të Projektit PMU/MEI, të marrë masa për arkëtimin e vlerës 2,582,666 euro, nga subjekti, **si dëm ekonomik i shkaktuar nga mos llogaritja e penaliteteve për vonesat në përfundimin e kontratës “Ndërtimi i nënstacionit 400/220 kv Tirana 2 dhe zgjerimi i nënstacionit ekzistues Elbasani 2”.**

Menjëherë

4. -Në zbatimin e punimeve civile në tenderin me objekt objekt “**Ndërtimi i Qendrës së re Dispeçer dhe të Telekontrollit**” për disa zëra punimesh janë kryer disbursime më tepër, duke përfituar padrejtësisht bashkimi i shoqërive të përkohshme të (ATI), në vlerën **234,957 euro, duke shkaktuar një dëm ekonomik për OST SH.A.** (Trajtuar më hollësisht në faqet 56-57 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

Për sa më sipër rekomandojmë:

OST SH.A të marrë masa për arkëtimin e shumës **234,957.20 Euro**, dëm ekonomik i shkaktuar nga pagesat e përfituara më tepër nga bashkimi i shoqërive të përkohshme, për punime civile të pa kryera por të likuiduara, për kontratën me objekt “**Ndërtimi i Qendrës së re Dispeçer dhe të Telekontrollit**”.

Menjëherë

5. -Mbi zbatimin e zërit “**Trajnime në fabrikën e, trajnime në Shqipëri dhe testimet e pajisjeve në fabrikë**”, u konstatua se është likuiduar vlera prej **1,278,009 euro**, e cila është e pa justifikuar me dokumentacionin që vërteton kryerjen e këtij shërbimi dhe **përbën dëm ekonomik për OST sh.a.** Mungojnë regjistrat e pjesëmarrjes në trajnime, relacionet e mbajtura pranë fabrikës së nga stafi i trajnuar, certifikatat e lëshuara sipas fushave përkatëse, kondra-biletat e udhëtimeve të kryera, dokumentacion i cili vërteton kryerjen e testeve në fabrikë, listë-prezencat e pjesëmarrësve në trajnime si në fabrikën e në Itali por dhe në Shqipëri, etj. (Trajtuar më hollësisht në faqet 59-60 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

Për sa më sipër rekomandojmë:

Njësia e Zbatimit të Projektit PIU/OST dhe OST SHA, të marrin masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës **1,278,009 euro**, nga subjekti, përfituar padrejtësisht nga kryerja e pagesave

për trajnimet dhe testimet, të cilat nuk rezultojnë të jenë kryer sipas rregullave dhe kushteve të kontratës.

Menjëherë

-Mbi zbatimin e zërit “Parts of telecommunication equipment” për nënstacionet përkatëse u konstatua se është likuiduar vlera **650,000 euro, e cila** i përket pajisjeve të reja të komunikimit por në fakt këto pajisje janë të vjetra dhe të bëra upgrade. S’ka asnjë dokument që vërteton se cilat karta janë vendosur (çmimi i tyre) dhe cilat janë bërë upgrade për secilën pajisje. (Trajtuar më hollësisht në faqet 61-62 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

6. Për sa më sipër rekomandojmë:

Njësia e Zbatimit të Projektit PIU/OST dhe OST SHA, të marrin masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës **650,000 euro**, nga operatori ekonomik, e përfituar padrejtësisht për furnizimin me pajisje të reja komunikimi, të cilat nga auditimi në objekt rezultuan se janë montuar pajisje të tjera.

Menjëherë

- Mbi zbatimin e zërit “Montim shelteri KAJAN dhe kolaudimi i tij”, u konstatua se ky shelter me vlerë **19,500 euro**, është dëmtuar totalisht dhe është jashtë pune. Shelteri, pas komisionimit dhe kolaudimit nuk është marrë në dorëzim nga OST SH.A dhe si i tillë ka ngelur nën përgjegjësinë e (Trajtuar më hollësisht në faqen 61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

7. Për sa më sipër rekomandojmë:

Njësia e Zbatimit të Projektit PIU/OST dhe OST SHA, të marrin masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës **19,500 euro**, nga operatori ekonomik, si pasojë e djegies së mallit i cili nuk është dorëzuar në OST SH.A.

Menjëherë

8. - Mbi zbatimin e zërave “Armadio FOX” tek Tirana Center Substation, “TVC 1-P”, “TVC 3-P”, “Izolatorë qelqi”, “Projektorë me aksesoret e montimit” dhe “Ekran projektimi i video projektorit”, është likuiduar fiktivisht vlera **140,795.21 euro**, pasi u konstatua se për këto mallra (pajisje) jo vetëm që mungon dokumentacioni justifikues i cili vërteton se mallrat kanë ardhur, janë magazinuar, janë kolauduar dhe testuar por mungojnë edhe pajisjet. (Trajtuar më hollësisht në faqet 61-62 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

Për sa më sipër rekomandojmë:

Njësia e Zbatimit të Projektit PIU/OST dhe OST SHA, të marrin masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës **140,795.21 euro**, nga operatori ekonomik, si vlerë e paguar fiktivisht për mallrat e mësipërm.

Menjëherë

C. MASA DISIPLINORE

C.1. Mbështetur në nenin 37, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, kërkojmë nga Administratori i OST SHA, të fillojë procedurën për dhënien e masës disiplinore “**Zgjidhje të kontratës së punësimit**”, sipas shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit për personat e mëposhtëm:

1. Znj., në cilësinë e Mbikëqyrëses së projektit sepse:

-nuk ka mbajtur situacionet përkatëse dhe dokumentacionin justifikues ku të vërtetohet se punimet apo shërbimet janë kryer përpara se të miratonte pagesat e MLS 2 në vlerën **1,914,453.84 euro**, MLS 3 në vlerën **2,552,605.12 euro**, MLS 4 në vlerën **1,914,453.84 euro** dhe MLS 6 në vlerën **1,276,302.56 euro**.

-nuk ka hartuar relacionin në lidhje me investimin e panevojshëm në vlerën e **364,300 euro**, me impakt negativ për OST SH.A pa ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet.

- nuk ka ndjekur procedurën e marrjes në dorëzim të pajisjeve të montuara dhe të komisionuara nga, si pajisje që aktualisht kanë kohë që u ka kaluar periudha e garancisë dhe nuk mund të ndahen përgjegjësitë në rast dëmtimi.

-nuk ka mbajtur aktet teknike mbi defektet e ndodhura në sistemin SCADA, siç është rasti i djegies së “shelherit” në KAJAN, në vlerën **19,500 euro**, i cili nuk mund të monitorohet pas djegies, e si rrjedhojë as nënstationi KAJAN por dhe për kartat e RTU të hequra nga nënstationi ELB 2.

-nuk ka mbajtur akt teknik mbi mosfunksionimin e shelherit në nënstationin Marinzë duke ndikuar negativisht në monitorimin dhe funksionimin e këtij nënstationi.

-nuk ka mbajtur akt teknik mbi mangësinë e “Dhënësit” të CM nënstationi Sharrë.

- nuk ka mbajtur relacion mbi gjendjen teknike të pajisjeve në nënstationin Traktori.

-nuk ka mbajtur relacion mbi upgrade-t e kryera tek FOX-et ekzistuese.

-nuk ka mbajtur relacion mbi gjendjen e bllok-kontakteve të nënstationit Selenicë.

-nuk ka mbajtur relacion për ndryshimin e vendit të montimit për shelherat Plepa dhe Tirana 2 të cilët janë montuar në nënstationin Fierzë.

-nuk ka mbajtur relacion për implementimin e sistemit SCADA tek Tirana 2 në kundërshtim me projektin.

-nuk ka mbajtur relacion teknik

-nuk ka kryer detyrën e ngarkuar si Mbikëqyrëse e Projektit, sipas urdhrit të brendshëm nr.1416 prot., datë 24.05.2011. *(Trajtuar më hollësisht në procesverbalin 3 datë 21.07.2015).*

C.2. Mbështetur në nenin 37, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, kërkojmë nga administratori i OST SHA, të fillojë procedurën për dhënien e masës disiplinore **“Vërejtje me paralajmërim për pushim nga puna”**, sipas shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit për personat e mëposhtëm:

1. Z., me detyrë përgjegjës i nënstationit Tirana 2, në cilësinë e mbikëqyrësit të sistemit SCADA, sepse:

-ka miratuar kryerjen e pagesave të punimeve ose shërbimeve të MLS 2 në vlerën **1,914,453.84 euro** dhe MLS 4 në vlerën **1,914,453.84 euro**, pa shoqëruar me dokumentacionin justifikues i cili vërteton kryerjen e tyre. *(Trajtuar më hollësisht në procesverbalin 3 datë 21.07.2015).*

C.3 Mbështetur në neni 58 germa “ç” të ligjit nr. 152/2013, datë 01.10. 2013 “Për nëpunës civil” i ndryshuar, dhe VKM 115, datë 05.03.2014, datë 26.2.2014, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, kërkojmë nga Ministri i Energjisë dhe Industrisë, të fillojë procedurën për dhënien e masës disiplinore **“Largim nga shërbimi civil”**, sipas shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit për personat e mëposhtëm:

1. znj., në cilësinë e ish-shefes së PIU/OST SHA, aktualisht Drejtore e Drejtorisë së Koncesioneve, Prokurimeve, Shpronësimeve dhe Privatizimeve, pasi:

-ka miratuar kryerjen e punimeve ose shërbimeve pa dokumentacionin justifikues që vërteton kryerjen e tyre, siç citohet në miratimin e pagesës për MLS 3 në vlerën e **2,552,605.12 euro**.

-ka hartuar një kontratë shtesë në të cilën janë përfshirë edhe zëra që kanë qenë pjesë e preventivit bazë në vlerën **435,098.20 euro**.

-Vlera e kontratës me objekt “Realizimi i qendrës së re të dispeçerisë dhe telekontrollit dhe ndërtimi i selisë së re të OST” është në shumën 21,899,436 euro. Për këtë kontratë ka dhe një amendament më datë 23.12.2010, për shtyrje të afatit të përfundimit dhe shtesë të vlerës së kontratës në shumën 1,100,106 euro. Për shumën në fjalë PIU/OST, ka marrë miratim nga zyra e Cooperacionit italian, por nuk është marrë miratim nga donatori Artigiancass, i cili duhet të miratojë futjen e shumës së shtesës në linjën e kredisë, veprim ky në kundërshtim me marrëveshjen e realizimit të projektit, të miratuar me VKM nr. 202, datë 5.04.2006, nenin 14 “Ndryshimet”, ku përcaktohet se çdo ndryshim i marrëveshjes duhet të bëhet nëpërmjet shkëmbimit të notave, nëpërmjet kanaleve diplomatike.

Gjithashtu theksojmë se shuma e shtesës ka kaluar dhe fondet e akorduara nga kredia e MC Centrale për projektin “Ristrukturimi dhe fuqizimi i sistemit elektrik Shqiptar për integrimin në sistemin e Ballkanit”, si dhe ka kaluar vlerën e fondit limit të përcaktuar në planin e kombinuar të prokurimit me shumën 1,086,666 euro (24,740,000 euro vlera e planit të prokuruar – 25,826,666 euro vlera e kontraktuar me gjithë shtesën).

Për ndryshimin e Planit të Prokurimit nuk është marrë miratim te donatori, mungon shkresa për miratim të këtij plani, veprim i cili është në kundërshtim me nenin nr. 5 të Marrëveshjes Financiare, shtojcat nr. 2 dhe nr. 3 të saj, si dhe në kundërshtim me Marrëveshjen “Për realizimin e “Programit për ristrukturimin dhe fuqizimin e sistemit elektrik shqiptar për integrimin në sistemin e Ballkanit: Fuqizimi i aftësive të transmetimit dhe përmirësimi i kontrollit”, miratuar me VKM nr. 220, datë 05.04.2006 e marrëveshjen financiare ratifikuar me ligjin nr. 9657, datë 11.12.2006.

Për sa më lart rezulton se shuma **1,086,666 euro ka rënduar koston e projektit objekt auditimi**.

Diferenca 416,973.32 euro nuk është argumentuar fare dhe nuk ka dokumente që vërtetojnë realizimin e punimeve sipas preventivit dhe projektit të zbatimit. Për punimet e mësipërme nuk është mbajtur librezë masash, ku argumentimi i volumeve për punët e kryera të jetë bërë në mënyrë analitike. Situacioni është nënshkruar nga OST Sh.a nga mbikëqyrësi dhe ku theksohet punimet e kryera në fakt në objektin OST Kashar të përfshira në MSL 4E, janë punimet b/a të pllakës së themelit, kollonave, trarëve, soletave të kateve të të gjithë ndërtesës deri në kuotën + 10.95 m të seksionit CNC dhe të OST. Disbursimi për punimet e ndërtesës në vlerën 309,030.08 Euro nuk është argumentuar nga mbikëqyrësit e punimeve me dokumentacion teknik si: situacioni, ditari i punimeve si dhe nuk është mbajtur librezë masash.

- nuk ka marrë masa për mbajtjen e penalitetit për vonesën në realizimin e punimeve, veprim në kundërshtim me kontratën e lidhur më datë 21.02.2008, Kushtet e Veçanta të Kontratës, volumni 2, seksioni 3, pika CS-34, **i cili ka shkaktuar një dëm ekonomik në shumën 1,299,152 euro, detyrim dy që duhet të paguhet nga kontraktori** veprim ky në kundërshtim me kushtet e kontratës datë 21.02.2008. Për ndërtimin e linjës 400 kv Tirana 2, është lidhur kontrata, nr. PRSEAISB/OST/PIU/CLA/02/08, datë 21.02.2008, ndërmjet OST SHA dhe kompanisë me vlerë 12,991,520,64 euro, me afat për përfundimin e punimeve 540 ditë nga data e hyrjes në fuqi të kontratës. Punimet kanë përfunduar në dhjetor të vitit 2011 dhe penaliteti që aplikohet për çdo javë vonesë është 0.5% të vlerës përfundimtare të kontratës. Shuma e llogaritur e penalitetit

për vonesën në realizimin e kësaj kontrate është 1,299,152 euro. Kontrata ka përfunduar në datë 23.03.2010. *(Trajtuar më hollësisht në procesverbalet 1-4 datë 21.07.2015).*

C.4. Mbështetur në neni 58 germa “a”, të ligjit nr. 152/2013, datë 1.10. 2013 “Për nëpunës civil” i ndryshuar, dhe VKM 115, datë 05.03.2014, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil” datë 26.2.2014 kërkojmë nga Ministri i Energjisë dhe Industrisë, të fillojë procedurën për dhënien e masës disiplinore “**Vërejtje**”, sipas shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit për personat e mëposhtëm:

1.Znj. specialiste e Drejtorisë së Integritit dhe projekteve në MEI, në cilësinë e specialistes së PMU/MEI, pasi .

-Për pagesat e konsulentit PMU/MEI, nuk ka bërë ndalesën e tatimit të të ardhurave në masë 10%. Kompania, nuk rezulton se është subjekt rezident në vendin tonë dhe nuk është regjistruar në QKR.

- nuk ka kërkuar dhe nuk ka bërë ndalesa në masën 10% e tatimit në burim për të ardhurat e përfituara nga kompania dhe të gjeneruara në territorin e RSH, veprim ky në kundërshtim me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, ku në nenin 5 përcaktohet se “Tatim” është pagesa e detyrueshme dhe e pakthyeshme në Buxhetin e Shtetit, apo në buxhetin e organeve të qeverisjes vendore. Për kontratën e lidhur për shërbime inxhinierike nuk është mbajtur për çdo pagesë në masën 10%, veprim ky në kundërshtim me nenet 4, germa “c”, 7 si dhe nenin 33, germa “d” e pika 2, të ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” me ndryshimet përkatëse, të Udhëzimeve të Ministrisë së Financave të nxjerra në zbatim të tij, me nenet 6 pika 1, 8 pika 2 dhe 9 të ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, si dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 6, datë 10.02.2004 “Për marrëveshjet bilaterale për shmangien e taksimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal”. --duhet të kishte kërkuar zbritjen e vlerës së tatimit mbi të ardhurat e përfituara nga kompania konsulente, në masën 10% për çdo pagesë të kryer dhe shuma përkatëse duhej mbajtur dhe derdhur në Degën e Tatimeve Tiranë. Nga sa më sipër rezultoi se, për Buxhetin e Shtetit është shkaktuar **një dëm ekonomik në shumën 222,654 euro.** *(Trajtuar më hollësisht në procesverbalint 1 datë 21.07.2015).*

D. KALLËZIM PENAL

Bazuar në ligjin nr.7905 datë 21.03.1995 “Kodi i procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar nenin 281, për shkelje të ligjit nr. 10233, datë 11.02.2010, i ndryshuar, për shkelje e konstatuara me pasojë dëm ekonomik, për projektin “Ndërtimi i qendrës së re dispeçer dhe sistemi SCADA EMS” për programin “Ristrukturimi dhe fuqizimi i sistemit elektrik shqiptar për integrimin në sistemin e Ballkanit: Fuqizimi i aftësive të transmetimit dhe përmirësimi i kontrollit” KLSH ka depozituar pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, kallëzimin penal nr. 516/13, datë 22.09.2015, respektivisht për, me detyrë ish-Drejtores e Njesisë së Zbatimit të Projektit në OST Sh.a. dhe, në cilësinë e Mbikëqyrëses Kryesore të Punimeve, me akuzën e “Shpërdorimit të detyrës” parashikuar nga nenin 248 i Kodit Penal, si dhe i ka rekomanduar OST Sh.a. dhe Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë marrjen e masave të

ndryshme disiplinore deri në largim nga shërbimi civil për dy drejtues dhe dy punonjës të këtyre dy institucioneve ende në detyrë.

Shënim: Gjatë trajtimit të çështjeve në Raportin e auditimit janë konstatuar përgjegjësi për; znj., në cilësinë e mbikëqyrëses së punimeve të ndërtimit për kontratën me objekt “Ndërtimin e Qendrës së re Dispeçer dhe të Telekontrollit”, z., në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve të ndërtimit për kontratën me objekt “Ndërtimin e Qendrës së re Dispeçer dhe të Telekontrollit” Tiranë dhe z. në cilësinë e mbikëqyrësit të sistemit SCADA, për të cilët nuk rekomandojmë masa disiplinore duke i konsideruar të ezauruara, për arsye se nuk janë në marrëdhënie pune me OST SHA, si dhe nuk kanë adresim institucional për dhënien, ndjekjen e zbatimin e tyre. Ngarkohet OST SHA të njoftojë Departamentin e Administratës Publike për rezultatet e auditimit të KLSH për këto persona.

Gjithashtu, edhe për z. në cilësinë e ish-drejtorit të PMU/MEI, për përgjegjësitë e konstatuara në Raportin Përfundimtar, nuk rekomandojmë masë disiplinore, duke e quajtur të ezuruar, për arsye se ky person nuk është në marrëdhënie pune.

Shënim: Auditimi u krye nga audituesit Yllka Pulashi, Mimoza Bedini, Skënder Mucaj Pirro Imeraj dhe Altin Tafilaj, më tej u shqyrtua nga k/auditues Fatmir Iliazi, Drejtori i Departamentit Xhaferr Xhoxhaj, Drejtori i Departamentit Juridike dhe Sigurimit të Standardeve Ermal Yzeiraj.